

Fillimi > -Kronikë

VIDEO-EMRAT/ Me armë zjarri e municion luftarak të fshehur poshtë sediljes së makinës, “Shqiponjat” arrestojnë fierakun, nën hetim bashkëpunëtori

15 Korrik, 2022 10:55



Madhësia e tekstit: - +

- Policia e Fierit dhe Forcat “Shqiponja” kanë finalizuar operacionin “Levani”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje.
- Gjatë aksionit, është arrestuar shtetasi Ermal Osmenaj dhe proceduar shtetasi Erjon Bushi, si dhe janë sekuestruar një armë zjarri pistoletë, një krehër me municion luftarak dhe 2 aparate celulare.

Njoftimi i plotë:

Gjenden një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak, në një automjet, vihet në pranga pasagjeri që i kishte fshehur poshtë sediljes.

Procedohet penalisht drejtuesi i automjetit, për moskallëzim krimi.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë, një krehër me municion luftarak dhe 2 aparate celulare.

Shërbimet e Sektorit Operacional në DVP Fier, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Fier dhe Forcën e Posaçme “Shqiponja”, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë policore, kanë organizuar dhe finalizuar me sukses operacionin policor të koduar “Levani”.

Si rezultat i këtij operacioni, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit E. O., 26 vjeç, banues në Vlorë, për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftatak”.

Gjithashtu, u procedua penalisht në gjendje të lirë, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, shtetasi E. B., 28 vjeç, banues në Vlorë.

Mbrëmjen e djeshme, në Levani, gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin me drejtues shtetasin E. B. dhe me pasagjer shtetasin E. O., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë me krehër dhe municion luftarak, që ishin fshehur poshtë sediljes së pasagjerit.

Drejtuesi i mjetit, shtetasi E. B. ka patur dijeni për armën dhe nuk kallëzuar në Polici.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për veprime të mëtejshme procedurale.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: arme arrestim fier municione

TË NGJASHME



Arrestohet në Muriqan 32-vjeçari nga Kazakistani i shpallur në kërkim ndërkombëtar, pritë ekstradimi drejt Gjermanisë

16 Korrik, 2022



VIDEO/ Me këmishë e shishe uji në dorë, dalin pamjet e arrestimit të bosit të drogës, SHBA kishte ofruar 20 milionë dollarë për kokën e tij

16 Korrik, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Zjarr në Rubjekë të Maminasit, rrezikohen disa banesa, ndërhyrja e vështirë

16 Korrik, 2022



Turistët serbë bllokohen në "Majën e grykave të hapura" në Valbonë, ndërron jetë një prej tyre

16 Korrik, 2022



Zbulohet shënjestra e celulës terroriste në Shqipëri, kush është numri dy i MEK që i rrezikohet jeta (EMRI-DOSJA)

16 Korrik, 2022




Aksident në Kavajë, makina përplas të miturin, arrestohet shoferi

16 Korrik, 2022



"Policë plehra, legenë"! Zbardhet dosja, akuzë e re për Lavdrim Tufën, si i rrahu oficerët e policisë autori i masakrës së Kartodromit

Klodiana Lala | 16 Korrik, 2022



"Do ta kryejmë punën, po presim lajme nga ty"! Zbulohen SMS-të e anëtarëve të celulës terroriste, takoheshin në hotele të njohura në Tiranë

16 Korrik, 2022

KATEGORIA VIDEO




Adoleshenti vdiq pasi u fut në det për të shpëtuar vëllanë dhe shokun, roja bregdetare: Tentuam ta shpëtonim, por...

Klodjana Hashaj | 16 Korrik, 2022




Kryetari i Qendrës për Ndikimin Hebre: Hebrejtë në Europë nuk ndihen më të sigurt, në Shqipëri 100% të integruar, jeni unikë në botë! BE duhet të bëjë më shumë përpjekje!

Aurora Golemi | 15 Korrik, 2022



VIDEO/ Tensione në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut, përplasen dy deputetë

15 Korrik, 2022




VIDEO/ Veprimi i Joe Biden bën xhiron e rrjetit, pas konferencës me homologun izraelit i jep dorë...

15 Korrik, 2022



"Dhuro gjak, shpëto jetë"/ Meta: Të japësh pa marrë asgjë në shkëmbim, thelbi i aleancës sonë. Promovues i kësaj kauze humane!

15 Korrik, 2022



Diplomohen studentët e 'Albanian University', mesazhi i drejtuesve të Universitetit për të rinjtë: Mos ikni nga atdheu!

15 Korrik, 2022

